



Trajneri i Skenderbeut, Mirel Josa duke komentuar per ndeshjen pas perfundimit te takimit me Kukesin e vleresoi lojen e skuadres se tij ndaj nje kundersharti te forte, ndonese ndeshja perfundoi ne barazim. “NUK deshiroj te flas per rrethana jashte takimit. Per lojen mund te them se zhvilluam nje pjese te pare shume te mire dhe duhej te konkretizonim supermacine tone ndaj Kukesit. Patem presion ne pjesen e dyte, por patem fat dhe shenuam me kundersulm. Pesuam menjehere gol. Jam i kenaqur me barazimin sepse edhe mund te kishim humbur. NUK e di pse situata u acarrua ne fund te takimit, por neve na takon qe ta qetesojme gjendjen dhe jo ta accarrojme me teper. Une merrem vetem me lojen dhe detyra ime ishte te qetesoja lojtaret e mij. Nuk dua te bej komente dhe krahasime per gjendjen qe krijohet neper stadiume te ndryshme. Federata ka njerezit e saj per kete pune qe te bejne vleresimet e duhura. Kampionati eshte i gjate dhe asgje nuk ka perfunduar akoma edhe pse jemi te paret. Me Staroven nuk debatova, po diskutonim rreth ndeshjes”, u shpreh trajneri Mirel Josa pas perfundimit te takimit me Kukesin.